

Date: ___ / ___ / ___

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; Aplikim Leje Mjedisore Tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; "SINAMETA" Sh.p.k; K530038/3A
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Tiranë, Kavajë, Helmas, Helmas, Objekti tek Ura Darsit.
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; Implant Prodhim Betoni dhe Ngjic funksionim inert.
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; —
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; Agjencia Kombëtare e Mjedisit
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

(Ardian Sinameta)

Nr.kontakti

068 748 79 76



**PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE
PËR AKTIVITETIN**

**“Impiant prodhim Betoni dhe Nyje fraksionimi
inertesh”**



Subjekti: “ SINAMETA” Shpk

Vendndodhja: Tirane Kavajë Helmes Helmas Objekti tek Ura Darçit

Ardian Sinameta



Tirane, 2018

Permbajtja

1. Hyrje

1.1 Te pergjithshme

2. Pershkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional

3. Pershkrim i mjedisit te rajonit

3.1 Pozita gjeografike

3.2 Klima

3.3 Arkeologjia

3.4 Burimet ujore

3.5 Flora dhe fauna

4. Pershkrimi i aktivitetit

4.1 Profili i propozuesit

4.2 Informacion per qendrat e banuara (distanca nga qendra e banuar dhe njesia e qeverisjes vendore qe administrojnë territorin ku zhvillohet projekti)

4.3 Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/prpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit)

5. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis lidhur me aktivitetin

5.1 Ndikimet ne popullsi

5.2 Ndikimet ne klime

5.3 Ndikimet nga zhurmat

5.4 Ndikimet ne toke

5.5 Ndikimet ne ajer

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

5.7 Ndikime ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe transportit

5.8 Ndikimet mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike

5.9 Ndikimet me natyre nderkufitare

5.10 Ndikimet ne ujera

1.HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Shoqeria "SINAMETA" SHPK eshte nje subjekt i regjistruar ne Qedren Kombetare te Biznesit numri i identifikimit te subjektit NIPTI: **K53003813A**, me Administrator **Z. Ardian Sinameta**. Shoqeria eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e prodhimit te betonit, prodhim inerte. Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Ne baze te Ligjit Nr. 60/2014 Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.07.2011, “Per lejet e mjedisit”, te ndryshuar, subjekti duhet ti nenshtrohet procedurave per Pajisje me Leje Mjedisit te Tipit B, perkatesisht me ID:

Industria minerare

1. **ID 3.1 pika e** “Perzierja e çimentos ose perdorimi i çimentos me mase te madhe por jo ne sheshin e ndertimit perfshire ambalazhimin dhe perzierjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos”.
- **ID 3.10:** Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve te tjera minerale jometalike.

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambient te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth. Vendosja e impiantit te prodhimit te betonit ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj.

Brenda sheshit jane te vendosura:

- Impianti i prodhimit te produkteve te betonit
- Mjediset e zyrave dhe ate higjenosanitare
- Sheshi per depozitimin e fraksioneve te ndryshme
- Sheshi per tharjen e produkteve prej betoni
- Sheshi per reklamimin e produkteve

Gjithashtu ne kete ambient bejne pjese edhe hapesirat per levizjen e mjeteve, njerezve dhe siperfaqet e gjelbera, oborri i cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambienteve.

2. PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Disa nga ligjet, aktet ligjore e nenligjore mbi te cilat mbeshtetet hartimi i ketij dokumenti, paraqiten si me poshte:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 ‘ Per Mbrojtjen e Mjedisit ’*
- *Ligji Nr16/2014 “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis“*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 ‘ Per Lejet e Mjedisit’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ‘Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes’.*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 ‘Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore’*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 ‘Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 ‘Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.’*
- *Udhezim per dokumentacionin e duhur per “Leje Mjedisore”*
- *Urdhëri Nr. 321 datë 11.02.2014 “Për Lejet Mjedisore”*

3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Pozita gjeografike

Rrethi i Kavajës është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Tiranës. Rrethi i Kavajës ka rreth 105,000 banorë (sipas 2004), një sipërfaqe prej 393 km² dhe kryeqendër Kavajën. Rrethi i Kavajës ka një sipërfaqe prej 20,000 ha. Shtrihet në pjesen e ultësirës perendimore duke u kufizuar në perëndim më d tin Adriatik, në lindje më rrethin e Tiranës, në veri me atë të Durrësit, jug-lindje me rrethin e Peqinit e në jug me rrethin e Lushnjes. Popullsia është rreth 110,000 banorë, ku Kavaja si qytet ka një popullsi prej 35,000 banorësh. Rrethi i Kavajës përshkohet nga dy përrenj të mëdhenj, ai i Leshnicës me drejtim të rrjedhës nga lindja në perëndim. Është kryesisht një rreth bujqësor me tokë bujqësore nën ujë 13,500 ha. Fusha e Kavajës ka një sipërfaqe prej 7,000 ha. Në jug përshkohet nga lumi Shkumbin që shërben edhe si ndarja administrative midis rrethit të Kavajës dhe atij të Lushnjës. Ka një vijë bregdetare prej afërsisht 18 km.



3.2 Klima

Kavaja është një qytet i cili ndodhet në rajonin perëndimor të Shqipërisë. Kavaja kështu nuk ka shumë male të larta, përkundrazi kryesohet nga një reliev fushor-kodrinor. Kjo nxit ekonominë në Kavajë. Kavaja ka si një pikë kryesore orientimi Kepin e Lagjit, ky i cili laget në tre anët e tij me ujërat e detit Adriatik. Tjeër pjesë relievi është dhe lumi Shkumbin i cili e përshkon Kavajën mes për mes. Megjithëse ka reliev fushor-kodrinor, Kavaja ka akoma disa male. Duke nisur në lindje të tij me malin më të lartë të Kavajës, malin Mënglë i cili është 404m i lartë. Në veri të Kavajës shtrihet mali i Zhurit, 256m i lartë. Në jug të tij shtrihet mali Frang, i cili është 311m i lartë. Tjetër pjesë relievi në Kavajë është përroi i Lishjatit i cili kalon në mes të Kavajës gjithashtu. Lartësia e Kavajës është 34m mbi nivelin e detit.

3.3 Arkeologjia

Territori ku ndodhet sot qyteti i Kavajës dhe rrethi i saj lidhet ngushte me historinë shumeshekullore të Durrësit të lashtë dhe mesjetar. Historia e tij nuk mund të kuptohet e shkeputur nga ajo e prapatokës (hinterlandit) së tij. Për zanafillën e Kavajës si qendër banimi ka patur mendime të ndryshme. Deri vone, studiues të ndryshëm në përgjithësi kishin mendimin se zanafilla e Kavajës si qendër e banuar duhej kerkuar diku nga mesi i shekullit XVI. Mirepo, duke u mbështetur në zbulimet e disa fragmenteve arkitekturore dhe në disa mbishkrime, del se zanafilla e këtij vendbanimi duhet parë deri në shekujt e parë, para erës sone.

Perveç ketyre te dhenave, nga studimet e arkeologut Halil Myrto per qendrat arkeologjike te Zig-Xhafes, te Kanapares, te Spanjojt dhe te Qerretit, qe ndodhen ne periferi te qytetit te Kavajes, vertetohet ekzistenca e qyteterimit ne kete zone, ne periudhen helenistike. Keshtu p.sh., nga gjetja ne kalane e Zig-Xhafajt, qe i perket shekujve IV-II para eres son, nxirret si perfundim se ne Zig-Xhafaj, gjate ketyre shekujve, ka ekzistuar nje qyteze ilire e tipit Castellum qe sherbente si vendbanim, si qender administrative, si religjioze dhe si vend strehimi per banoret e zones ne raste lufterash. I rendesishem eshte fakti se kjo eshte e vetmja kala ilire, qe njihet deri me sot ne rrethin e Durresit.

Ne vazhdim te kerkimeve, arkeologu H.Myrto ne fshatin Spanjo dhe Aganas (shume afer lagjes Sallbeg-Kavaje) ka gjetur fragmente te shumta tullash dhe tjegullash te periudhes helenistike. Krahas gjetjeve arkeologjike, meqenese zona e qytetit te Kavajes qe nga shek. I p.e.s. perfshihej mbrenda territorit te Durresit, (i cili shtrihej deri tek vendi i quajtur nga Qezari, asparagum Dyrhachinorum, nje etape marshimi drejt jugut ne Shkumbin dhe meqenese neper Kavaje kalonte Via Egnatia, dy arkeologet franceze erdhen ne perfundim te gjykonin se ne Kavaje ka ekzistuar nje lokalitet i banuar VICUS.

Keto perfundime plotesoheshin me pare edhe me zbulimin ne Kavaje nga arkeologu gjerman Han, me 1853, tek nje gur varri me nje bazorelief qe paraqiste tri figura ne kembe. Perveç ketyre dokumenteve, Hezej dhe Domje e lidhin qenjen e ketij VICUSI ne Kavaje me faktin se ky vend furnizonte me mermer romaket.

3.4 Burimet ujore

Per sa i perket burimeve ujore, permenden me se shumti ato te kripura te Golemasit. Ndodhen në afërsi të fshatit Golemas, rreth 110 m mbi nivelin e detit, pranë toponimit mjaft interesant Posta e Golemit.

Janë burime me ujë të kripur, që dalin, duke pulsuar dhe me zhurmë karakteristike në masën e argjilit, pasi kanë përshkuar shtresat e kripës së gurit. Ato kanë prurje jo të njëjtë dhe dalin në një areal mbi 2 ha. Në stinën e verës, masa e ujit e përzierë me baltë bëhet shumë viskoze.

3.5 Flora dhe fauna

Flora dhe fauna e ketij qyteti nuk ka specie te rralla apo ne zhdukje.; ne qytetin e Kavajes gjenden bime te ndryshme, shkurre te uleta si dhe bime mjekesore. Nga gjitaret permenden lloje si dhelpra, cakalli dhe shpende te shumellojshem. Ne burimet ujore, ne kanale e keneta gjenden bretkosa dhe lloje insektesh fluturues.

Flora konsiderohet deri diku si e pasur, qe konkretizohet me shume tipe te ndryshme bimësh. Ne kete territory mbizoterojne shkurret mesdhetare, deri ne nje lartesi te konsiderueshme duke pasur si me karakteristike: mërsinën, marene, shqopën, dhe dushkullin e egër. Duke u afruar me detin, gjenden fiqtë e detit, dafina, fiqtë, shqoza e zeze, eukaliptet etj.

4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Profili i propozuesit

Subjekti “SINAMETA” Shpk kryen aktivitetin “ Impiant prodhim Betoni dhe Nyje fraksionimi inertesh”. Eshte regjistruar ne QKR me date: **01.01.2005**, i pajisur me nr. Identifikim NIPT: **K53003813A** , me Administrator **Ardian Sinameta**. Ky subjekt ushtron aktivitetin me adrese ne: **Tirane Kavajë Helmes Helmas Objekti tek Ura Darçit.**

Pra me kete **Permbledhje Joteknike** jepet informacion per projektin qe eshte realizuar, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga investitori per zbatimin e kriterëve per mbrojtjen e menaxhimin e qendrueshem te mjedisit, ne territorin e objektit.

Vendndodhja ku subjekti ushtron aktivitetin ka koordinatat e meposhtme te percaktuara sipas sistemit **GAUSS-KRUGER** duke u paraqitur edhe ne ortofoton bashkengjitur:



Pika Nr.1

Pika Nr.2

Koordinatat		
Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 35' 10.2142"	41° 9' 1.2336"
UTM Zone 34N	381363.74	4556410.04
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4381446.83	4558364.42
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	465261.58	4557352.20

Koordinatat		
Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 35' 15.3898"	41° 9' 3.2258"
UTM Zone 34N	381485.38	4556469.52
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4381568.52	4558423.92
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	465382.56	4557413.09

Pika nr.3

Koordinatat		
Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 35' 16.4713"	41° 9' 1.0010"
UTM Zone 34N	381509.47	4556400.50
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4381592.62	4558354.87
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	465407.45	4557344.33


Pika nr.4

Koordinatat		
Sistemet koordinative	Easting	Northing
ETRS89	19° 35' 12.0875"	41° 8' 58.9215"
UTM Zone 34N	381406.25	4556338.03
Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4	4381489.36	4558292.38
KRGJSH 2010 / ETRS89 Transverse Mercator	465304.92	4557280.67

4.2 Informacion per qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njesia e qeverisjes vendore qe administroin territorin ku zhvillohet projekti)

Vendi i zhvillimit te aktivitetit ndodhet ne : **Tirane Kavajë Helmes Helmas Objekti tek Ura Darçit**, larg qendrave te banuara, por mund te themi se kjo nuk perben ndikim negativ per mjedisin apo banoret pasi ky aktivitet nuk kryen aktivitet me clirime te demshme gazesh apo shkarkimesh te tjera te rrezikshme e me natyre ndotjeje.

Perkundrazi, vendosja e saj ne kete zone sjell vetem ndikime pozitive sepse jane punesuar nje numer i konsiderueshem i banoreve perreth (te nevojshem per plotesimin e fuqise punetore qe i duhet aktivitetit), duke rritur keshtu mireqenien e tyre ekonomike. E gjithë zona karakterizohet nga shtresa te holla toke me depertueshmeri te larte. Nuk ka objekte te mbrojtura gjeologjike, apo zona me interes gjeologjik. Mundesia e lekundjeve te theksuara sizmike eshte e ulet, pra ndertimi i ketij objekti ne kete territor eshte studiuar duke arritur ne perfundimin se ky eshte nje pozicion i favorshem strategjik.



4.3 Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit)

➤ **ID 3.1 pika e** “Perzierja e çimentos ose perdorimi i çimentos me mase te madhe por jo ne sheshin e ndertimit perfshire ambalazhimin dhe perzierjen e cimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te cimentos”.

- **Lendet e para, lendet ndihmese, produkte te ndermjetme dhe produkti perfundimtar**

Per prodhimin e betonit perdoren si lende e pare dhe lende ndihmese:

- rere e gurit
- granil
- cemento
- uje
- inerte guri te fraksionuara


Produkte perfundimtare te perftuara pas kryerjes se procesit teknologjik jane:

- betoni i markave te ndryshme

- **Mbi veprimtarine**

Makineria e prodhimit te bllokut vetelevizese BDA 100X100 eshte ndertuar per formimin e objekteve prej betoni te formave dhe dimensioneve te ndryshme ne varesi te kallepit te perdorur. Makineria eshte e perbere nga nje structure celiku ne te cilen jane vendosur te gjitha pjeset per funksionimin e akinerise, mekanizmat, impianti elektrik dhe hidraulik. Betoni mbushet ne nje kove te pajisur me nje instrument qe na tregon nivelin minimal, mungesa e inerteve ndalon funksionimin automatic te makinerise. Betoni hiqet nga kova nga nje “sirtar” levizes, i cili eshte i pergjegjshem per mbushjen e kallepit, levizja ekzekutohet nga nje seri komandash te dhena ne menyre hidraulike.

Para formimit te objektit (te betonit) makina pozicionon me ane te sistemit hidraulik nje pllake celiku nen kallep, pak milimetra toka. Pas mbushjes se kallepit me beton, nje sistem vibratoresh i aplikuar aty siguron nje mbushje ekselente te kallepit, ndersa nje sistem shtypes siguron kompaktesine e objektit. Piedestrals (kembe) special antivibruese zvogelojne ndikimin e vibrimit tek makineria. Pas mbarimit te formimit te objektit, makineria zhvendoset ose eshte e gatshme per fillimin e ciklit nga fillimi. Zhvendosjet e mevonshme kryhen nga rrota e pozicionuar ne mes te dy rrotave te tjera, kjo rrote e lidhur me sistemin hidraulik lejon ngritjen e



makinerise, duke liruar 2 rrotat e tjera, dhe keshtu mundesohet vazhdimi i ciklit te levizjeve te metejshme te makinerise.

Parimet e funksionimit.

Nje sonde e vendosur ne bazen e makinerise tregon per pranine e pengesave si p.sh (prezenca e objekteve prej betony te formuara me pare) dhe rivendos funksionimin normal te makines automatikisht nepermjet rrotes qendrore. Makineria eshte e pajisur me dy mundesi operimi:

- Cikli automatik i punes
- Funksionimi manual

Gjate operimit ne ciklin automatic, makina eshte e kontrolluar nga programi kompjuterik elektronik PLC dhe i kontrollon te gjitha manovrat pa nderhyrjen e operatorit, i cili duhet vetem te mundesoje mbushjen e kovës. Ne funksionimin manual, operatori mund te ekzekutoje te gjitha manovrat e kerkuara me ane te komandave elektronike dhe hidraulike, te vendosura ne tryezen e komandave te makines.


1. ***Depozita e lendes se pare.*** Ne impiantin e prodhimit te betoni, jane te instaluar depozita ku depozitohet lenda e pare (inerte dhe rere). Depozitat jane te pajisura me transportier, i cili vendoset ne pune me ane te rrulave, duke bere te mundur peshimin dhe recepturen e inerteve.
2. ***Kova e perbashket.*** Kova e perbashket e cila ndodhet e zhytur ne nje thellesi ku hidhet lenda e pare e pergatitur sipas receptures. Me ane te kavove, realizohet dergimi i lendes se pare nga depozitat e inerteve ne betoniere, ku dhe realizohet procesi i prodhimit te betonit.
3. ***Betoniere.*** Betonieria eshte e ngritur nga toka ne nje lartesi, per te lejuar nje perzierje me te shpejte te pastes se betonit. Gjithashtu ajo eshte e pajisur dhe me nje zgare e cila eshte e arritshme me ane te shkalleve me qellim komandimin, kontrollin dhe sherbimin e saj ne rast avarie. Betonierja rezlizon procesin e perzierjes se lendeve te para **inerteve + reres + cemento + uje**, sipas receptures se produktit te parafabrikuar qe eshte parashikuar te prodhohet. Miksimi i lendeve te para realizohet nepermjet rrotullimit e thjeshte dhe dopio te lopatave te miksuesit, te pajisura me shpatulla qe mbulojne te gjithe kazanin e betonieres duke realizuar nje perzierje te homogjenizuar te konglomerateve. Ne fund dhe ne faqet anesore te betonieres montohen unaza me perberje hekuri, duke rritur rezistencen e ferkimit te lopatave me kazanin e betonieres. Shkarkimi i betonit realizohet nepermjete pistonave hidraulik, te cilet bejne rrotullim e kazanit te betonieres.
4. ***Sillosi i cimentos.*** Sillosi i cimentos sherben depozitimin e lendes se pare cemento. Nga sillosi i cimentos me ane te nje elektromotori me thithje realizohet dergimi i cimentos per ne betoniere nepermjet nje tubi me gjatesi 8 m dhe diameter 20 cm, i cili realizon shkarkimin e cimentos ne peshore. Tubi i shkarkimit eshte i pajisur me nje valvur sigurie.
5. ***Procesi i prodhimit.*** Per prodhimin e produkteve te betonit perdoret material lende e pare rere dhe granil. Rera dhe granili mbahen ne depozita te vecanta. Rera dhe granili del ne fund te depozites dhe me ane te transportierit te perbashket qe realizon peshimin dhe recepturen, me pas kalojne ne koven e perbashket, e cila e dergon materialin e perzier ne betoniere. Nga sillosi i cimentos me ane te nje elektromotori me thithje realizohet dergimi i cimentos per ne betoniere nepermjet nje tubi me gjatesi 8 m dhe diameter 20 cm, i cili realizon shkarkimin e cimentos ne peshore.


Tubi i shkarkimit eshte i pajisur me nje valvur sigurie. Dergimi i ujit realizohet me anen e nje elektropompe te vogel, sipas kerkesave te receptures. Materiali (rere dhe granil) dhe cemento i futur ne betoniere perzihet, deri ne marrjen e receptures perfundimtare per prodhimin e betoni. Pergatitja e receptures, peshimi i lendeve te para e deri ne perfitimin e produktit perfundimtar eshte nje proces i automatizuar qe kontrollohet nga puti i kontrollit ne kullen e kontrollit. Levizja e lendeve te para relaizohet nepermjet sistemve te mbullura ne menyre qe te shmangen krijimi i pluhrave nga aktiviteti i linjes se prodhimit te produkteve prej betoni .

Pamje nga proceset dhe impiantet e instaluara



Makinerite e prodhimit





➤ **ID 3.10: Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve te tjera minerale jometalike.**

- *Nyje fraksionimi inertesh*
Mbi veprimtarine.

Ne objekt behet larja dhe fraksionimi i inerteve te grupit te peste duke synuar plotesimin e nevojave te tregut vendas ne fushen e ndertimit. Teknologjia e instaluar per veprimtarine e mesiperme eshte ne parametra optimal. Kapaciteti prodhues eshte 50 m³ ne dite. Produkti qe prodhohet ne kantier eshte fraksionimi i inerteve. Materiali inert do te sigurohet nga lumi Shkumbin. Impianti eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise.


Linja teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga 6 njesi baze te cilat jane te renditura si me poshte:

1. Bunkeri i depozitimit te inerteve eshte stacioni i pare i materialit i cili i nenshtrohet nje numri te caktuar procesesh. Ne bunker shkarkohet material inert i cili nepermjet forces terheqese gravitacionale drejtohet ne sistemin e pare te sitave.
2. Sistemi i pare i sitave eshte nje set sitash vibruese. Ketu realizohet nje ndarje fillestare grimcore e materialit inert bruto qe depozitohet ne bunker. Pjesa e fraksioneve qe depertojne ne kete system i perkasin fraksionit te reres i cili pastaj depozitohet ne vendin e caktuar ne shehin e kantierit.

3. Mulliri i coptimit dhe bluarjes se inerteve ku realizohet coptimi. Ne kazanin e mullirit.. eshte montuar nje system tubosh te cilet leshojne uje ne forme shiu. Copat shkojne ne rripin e transmisionit nr.2.
4. Transmesioni kryesor i fraksioneve te dala nga mulliri blures eshte rrip gome i cili realizon zhvendosjen ne njesine e sistemit te dyte te sitave.
5. Sistemi i sitave vibruese realizon klasifikimin perfundimtar granulometrik te fraksioneve te materialit inert qe coptohet ne mullirin e bluarjes. Ky system realizon ndarjen sipas fraksioneve dhe depozitimin e tij perfundimtar me bunkeret e ngarkimit te automjeteve.
6. Njesia e bunkerave fundor te depozitimit perfundimtar te fraksioneve eshte agregati i fundit. Ne kete agregat i perbere nga 5 bunkeret me kapacitet vellimor 20 m³ eshte realizuar perfundimisht procesi fraksionues i materialit inert.

Menaxhimi i instalimit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin e prodhimit te produkteve te parafabikuara prej betoni, per te cilin shoqeria "SINAMETA" SHPK operon ne tregun rajonal. Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar puna ne menyre te tille qe te funksionojne ne formen e nje organograme per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit.

Pak a shume hierarkia dhe rrjedhja e autoritetit tregohet ne kete skeme te thjesht ku cdo gje varet drejtpersdrejti nga Administratori dhe nga aksioneri i vetem i kompanise.



5.IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

Me poshte paraqitet nje analize e emetimeve ne mjedis qe mund te vijne nga ushtrimi i ketij aktiviteti. Per vete natyren e veprimtariseqe ushtron, subjekti i ka marre te gjitha masat per minimizimin e ndikimeve te mundshme negative ne komunitetin dhe mjedisin perreth duke realizuar mbrojtjen e te gjitha komponenteve mjedisore: te ujerave nentokesore e siperfaqesore, ajrit, tokes nga depozitimi i mbetjeve dhe mbrojtjes nga niveli i larte i zhurmave apo vibrimeve te betonit.

5.1 Ndikimet ne popullsi

Realizimi i aktivitetit nuk ka ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se ketij rajoni ku zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit jane marre te gjitha masat e nevojshme per reduktimin/minimizimin e emetimeve ne ajer, toke apo uje, te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo popullsisë se rajonit. Ne zhvillimin e aktivitetit nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsinë e zones, te zhvendosjes se saj per shkak te tij. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne shendetin mendor dhe fizik te popullsisë te ndodhur rreth vendit te ushtrimit te tij.

5.2 Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne drejtim te perkeqesimit te saj. Nuk ka ndryshime ne temperature ne drerjtim te eres apo sasise se rreshjeve. Pra, mund te thuhet se kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

5.3 Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, kamionat e punes dhe sitat vibruese te betonit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

5.4 Ndikimet ne toke

Ndotja e tokes mund te ndodhe si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem. Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali i granilit terhiqet vete nga sistemi i silloses se makinerise.

Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke. Automjetet dhe makinerite duhet te jene te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te tjera te grumbulluara gjate procesit teknologjik gjate transportit ne zonat urbane dhe me rruge te asfaltuara. Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktivitetet te jene te paisura me masa mbrojtese dhe te shtrojne siperfaqet ku ato veprojne.

Mbeturinat e ngurta vijne nga:

Aktiviteti human: mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe

do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones. Nga procesi teknologjik: vleresohet te kete mbetje te ngurta nga ambalazhet e produktit, si plastmas, leter, karton paleta druri. Persa i perkete materialit te demtuar, ai mund te rifutet ne procesin e prodhimit dhe te ripaketohet, ndersa ambalazhet e tyre, hidhen ne kontenieret e mbetjeve te ngurta te zones.

5.5 Ndikimet ne ajer

Ndotja e ajrit vjen nga pluhuri i granilit dhe reres te ekspozuara ne ambiente te hapura, si dhe nga aktiviteti i ngarkimit e shkarkimit te materialit. Procesi punes se impiantit perfshin procese te gjenerimit te pluhurave dhe per te minimizuar ndotjen e ajrit kryhet lagia dhe sperkatja here pas here me uje nga sistemi i tubacioneve te zones.

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambient te hapur dhe brenda siperfaqes se percaktuar per kete qellim keshtu qe nuk ka lidhje me mjedis tjetër, per rrjedhoje as derdhje te shkarkimeve apo mbeturinave qe mund te shkaktojne ndryshime ne floren e faunen e zones.

5.7 Ndikimet ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe te transportit

Aktiviteti nuk ka ndikim ne rruget lokale dhe te transportit, madje subjekti eshte angazhuar ne mirembajtjen e tyre me qellim mbarevajtjen e zhvillimit te aktivitetit te tij pasi ne keto rruge kalojne kamionat e ngarkim-shkarkimit qe shoqeria “SINAMETA” ka ne dispozicion.

5.8 Ndikimet mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike

Aktiviteti qe ushtron subjekti zbatohet ne nje zone ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike apo tiparet arkeologjike. Kjo tregon se zona eshte e lire per vazhdimin e ushtrimit te veprimtarise se ketij aktiviteti dhe njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

5.9 Ndikimet me natyre nderkufitare

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyre nderkufitare sepse ndodhet brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ne Kavaje dhe nuk ndodhet ne kufijte tokesore me shtetet e tjera qe kufizojne Shqiperine.

5.10. Ndikime ne ujera

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e sheshit te shoqerise
- Ujerat e pastrimit te ambientit te parkimit te makinerive dhe paisjeve te renda.
- Ujerat e perdorur per pastrimin e sheshit ku depozitohet lenda e pare.
- Ujerat e perdorura per qellime sanitare.

Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete aktivitet, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla. Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne ujerat e pastrimit te ambientit te punes dhe mjeteve te transportit. Procesi teknologjik perfshin perdorimin e ujit, por nuk ka shkarkime. Ndikimi nuk eshte me efekt domethenes ne mjedisin e zones.

Administrator

Ardian SINAMETA

